



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

**AD.GJTH.GJL.nr.15/24**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 03.10.2024 të parashtruar nga ankuesi A. Sh. nga Gjilani, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës M. A., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, më datë 04.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET e pabazuar** ankesa e parashtruar nga ankuesi A. Sh. nga Gjilani, e datës 03.10.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës M. A., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**A r s y e t i m**

Më datë 03.10.2024, parashtruesi i ankesës A. Sh. ka paraqitur ankesë urgjente, duke kërkuar nga autoriteti kompetent që të iniciojë procedurë disiplinore ndaj gjyqtarës M. A..

Në ankesë, i njëjti thekson se më datë 23.08.2024 ka kërkuar nga gjyqtarja M. A. që t'ia caktojë një datë për shikimin e shkresave të lëndës, mirëpo lidhur me këtë kërkesë nuk ka pranuar asnjë informatë apo përgjigje nga gjyqtarja në fjalë. Përsëri, më datë 26.09.2024 ka kërkuar nga gjyqtarja informata dhe veprime procedurale, por nuk i është lejuar qasja në shkresat e lëndës C.nr.1872/2020. Nga këto rrethana, ka vlerësuar se si pasojë e mos veprimit dhe neglizhencës së gjyqtarës, po shkelet ligji dhe po i mohohen të drejtat e garantuara me ligj, andaj ka propozuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës M. A..

Kryetari i gjykatës, pas pranimit të ankesës dhe analizimit të pretendimeve në të, ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkelje të mundshme disiplinore, prandaj lidhur me këtë çështje nuk ka kërkuar nga gjyqtarja që të deklarohet rreth pretendimeve të palës ankuese, meqë ka vlerësuar se ankesa është e pabazuar dhe pretendimet në ankesë nuk e justifikojnë iniciimin e procedurës disiplinore.

Deri te një përfundim i tillë, kryetari i gjykatës erdhi pasi vlerëson se pretendimet e ankuesit nuk përkojnë me asnjë nga shkeljet për të cilat mund të iniciohet procedura disiplinore të përcaktuara në nenin 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, apo me Kodin e Etikës.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e datës 03.10.2024, është e pabazuar dhe për të njejtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryetari i Gjykatës,  
Venhar Salihu**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtruesit të ankesës,
2. Gjyqtarës M. A.,
3. KGJK-së,
4. Dosjës së lëndës.